

UDHËZIM
Nr. 6, datë 4.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR AFATET E APLIKIMIT, TË ZBATIMIT TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT, SI DHE NUMRIN E ANËTARËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR ANËTARË KOMISIONI PËR DHËNIEN E BURSAVE TË PARASHIKUARA NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT CIVILË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikave 5 dhe 9, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë” (Fondi i Ekselencës),

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Studentët shqiptarë të shkëlqyer dhe nëpunësit civilë (në vijim “kandidatët”) mund të përfitojnë mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe financimin nga donacione ose të ardhura të tjera nga burime të ligjshme, për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë apo të ciklit të tretë, jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës, në përputhje me vendimin me nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”.

2. Për përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve përpara fillimit të vitit akademik dhe ndjekjen e ecurisë së tyre gjatë studimeve, ngrihet komisioni përzgjedhës nga ana e ministrit përgjegjës për arsimin, sipas përbërjes dhe kriterëve përzgjedhëse të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Komisioni përzgjedhës i kandidatëve kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues dhe ka në përbërje të tij 7 anëtarë si më poshtë:

- a) kryetari (ministri ose personi i deleguar prej tij);
- b) katër anëtarë, të cilët janë pjesë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe kanë titull akademik ose gradë shkencore “Doktor”;
- c) një anëtar, ish-përfitues i Fondit të Ekselencës, i cili ka përfunduar minimalisht studimet e ciklit të dytë;
- ç) një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike, në rastet e shqyrtimit të aplikimeve për kategorinë “Nëpunës civil”.

3.1 Në rastet kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.

4. Për administrimin e dokumentacionit të aplikimeve në programin e Fondit të Ekselencës dhe për ndjekjen dhe gurmimin e ish-përfituesve të Fondit të Ekselencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore/nënligjore dhe atyre të parashikuara në aktmarrëveshje, ministri përgjegjës për arsimin formon një Sekretariat Teknik të Programit (STP), të përbërë nga personel administrativ i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Përbërja dhe detyrat e STP përcaktohen me urdhër ministri, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

KREU II
PROCEDURAT E APLIKIMIT

1. Aplikimi për përfitim të mbështetjes financiare nga Fondi i Ekselencës kryhet vetëm në formën elektronike në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve.

2. Periudha gjatë së cilës kryhen aplikimet për secilin vit, për të gjitha kategoritë e përfituesve të përcaktuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar, shpallet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Aplikimet e dërguara jashtë afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose vetëm në formë shkresore nuk do të shqyrtohen.

4. Aplikimi për përfitim të mbështetjes financiare për ndjekjen e programit të ciklit të dytë (viti i parë), kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit *online*, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopje e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimin nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas “Times Higher Education” – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin);

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” (kopje e njehsuar me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Aplikimi për përfitim të mbështetjes financiare për ndjekjen e programit të ciklit të tretë “Doktoratë” (viti i parë) kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit *online*, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopje e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimin nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas “Times Higher Education” – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin).

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master” (kopje të njehsuara me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Aplikimi për përfitim të mbështetjes financiare nga nëpunësit civilë të cilët janë pranuar në një program “Master” të ciklit të dytë apo të tretë me kohëzgjatje 1-vjeçare (njëvjeçare), kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit *online*, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopja e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimin nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas “Times Higher Education” – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar);

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” dhe/ose të ciklit të dytë “Master” (kopje të njehsuara me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Dokumentet e paraqitura në ministrinë përgjegjëse për arsimin, duhet të jenë në gjuhë shqipe ose në gjuhë angleze, origjinale ose të njehsuara me origjinalin. Dokumentacioni në gjuhë të ndryshme nga

ajo shqipe dhe angleze duhet të paraqitet i përkthyer dhe i njehsuar me origjinalin nga përkthyes të licencuar.

8. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për studentët të cilët janë mbështetur nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për përfitimin e mbështetjes për vitin e dytë e në vijim të studimeve vetëm në ciklin që nuk e kanë përfunduar ende, kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. lista zyrtare e notave për vitin pararendës të studimeve, të financuar nga Fondi i Ekselencës (origjinale ose kopje e njehsuar);

ii. dokumentacioni justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar për vitin e mëparshëm.

KREU III PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Ministria përgjegjëse për arsimin sipas procedurës si më poshtë:

a) shpall hapjen e programit të fondit të ekselencës dhe afatet e aplikimit;

b) STP-ja njofton kandidatët me e-mail, për mbërritjen e aplikimit dhe për dokumentet shtesë që mund të duhen;

c) STP-ja pasi bën verifikimin e dokumentacionit, informon ministrin/komisionin përzgjedhës për numrin e aplikantëve dhe fushat ku ata kanë aplikuar;

ç) STP-ja vendos në dispozicion të komisionit përzgjedhës gjithë dokumentacionin e depozituar dhe e asiston teknikisht atë gjatë procesit të përzgjedhjes;

d) aplikimet e depozituara në secilin prej muajve të periudhës së aplikimeve të shpallur nga ministria përgjegjëse për arsimin, shqyrtohen nga komisioni përzgjedhës gjatë muajit vijues.

1.1 Fazat e përzgjedhjes:

a) STP-ja bën një vlerësim paraprak për plotësimin e kriterëve të parashikuar në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar dhe në këtë udhëzim, nga të gjithë kandidatët, duke përfshirë kandidatët që kanë përfituar mbështetje nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për vitin e dytë e në vijim të studimeve;

b) vlerësimi paraprak së bashku me dosjet e kandidatëve i kalon për shqyrtim komisionit i cili bën vlerësimin për çdo aplikant;

c) pas këtij vlerësimi, Komisioni merr vendimin për kandidatët që përfitojnë mbështetje nga Fondi i Ekselencës. Ky vendim zbardhet në procesverbalin përkatës në të cilin përcaktohet lista e kandidatëve fitues, si dhe shumat e financimit për secilin prej tyre të cilat janë përlllogaritur paraprakisht nga STP-ja pasi është marrë informacioni nga drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin mbi masën e fondit në dispozicion;

ç) në rast se pas vlerësimit të dokumentacionit të përcjellë nga STP-ja, Komisioni nuk arrin të krijojë bindje për një ose më shumë prej kandidatëve, ai mund të kërkojë kryerjen e verifikimeve dhe kërkimin e informacioneve shtesë nga STP-ja ose mund të kërkojë intervistimin e kandidatit/kandidatëve përkatës (vetëm për kandidatët e rinj që aplikojnë për mbështetjen e vitit të parë dhe nuk janë mbështetur më parë nga Fondi i Ekselencës);

d) në rast se Komisioni ka vendosur intervistimin e një ose më shumë kandidatëve, STP-ja njofton përmes e-mail-it kandidatët që janë përzgjedhur për t'u intervistuar për datat dhe vendin e zhvillimit të intervistave. Komisioni kryen intervistën me kandidatët përkatës dhe në përfundim të saj merr vendimin përfundimtar për këta kandidatë. Intervista kryhet në prezencë të kandidatit ose në rrugë telematike kur ai ndodhet jashtë vendit;

e) vendimet (procesverbalet e mbledhjes) e Komisionit i bashkëlidhen urdhrin të ministrit për shpalljen e kandidatëve fitues ku është parashikuar dhe masa e bursës së akorduar secilit prej tyre.

1.2 Shpallja e kandidatëve fitues:

a) lista e emrave me kandidatët fitues duke përfshirë të dhënat mbi programin e studimit, institucionin e arsimit të lartë, renditjen sipas “Times Higher Education” – renditja botërore e universiteteve, si dhe masën e financimit, bëhet publike në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) kandidatët njoftohen, përmes e-mail-it, për klasifikimin e tyre si fitues ose jofitues.

1.3 Lidhja e marrëveshjes:

a) ministria përgjegjëse për arsimin njofton kandidatët fitues për afatin për lidhjen e aktmarrëveshjes;

b) kandidatët fitues nënshkruajnë aktmarrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në emër të ministrisë përgjegjëse për arsimin nënshkruan Sekretari i Përgjithshëm i saj.

Nëse kandidati nuk mund të paraqitet personalisht, për nënshkrimin e aktmarrëveshjes autorizon me prokurë të posaçme një person tjetër që nënshkruan aktmarrëveshjen në emër të kandidatit;

c) për zbatimin e aktmarrëveshjes ngarkohet drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin, si përgjegjëse për veprimet financiare që bëhen me përfituesit e bursës.

1.4 Likuidimi i pagesës:

Kur kandidati shpallet fitues, shuma e miratuar me urdher ministri paguhet në llogarinë e përfituesit pranë një banke të nivelit të dytë në valutën e kërkuar.

2. Përfundimi i studimeve

a) me përfundimin e kohëzgjatjes zyrtare të studimeve, përfundon edhe mbështetja financiare në kuadër të këtij programi;

b) kandidatët mund të vazhdojnë studimet pa u financuar nga Fondi i Ekselencës deri në 1 (një) vit pas përfundimit të kohëzgjatjes zyrtare të studimeve, pas së cilës nuk do të konsiderohen më pjesë e këtij programi;

c) përfituesit e mbështetjes nga Fondi i Ekselencës dorëzojnë në STP një kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës master dhe listës së notave (dhe temës së diplomës nëse ka pasur të tillë), ose të diplomës së doktoratës dhe të disertacionit, dokumentacionin justifikues të shpenzimeve financiare, si dhe një Jetëshkrim të hollësishtëm, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i studimeve.

3. Programi “Alumni – Ekselencat”

Të gjithë përfituesit nga Fondi i Ekselencës, pas përfundimit të studimeve “master”, do të bëhen anëtarë të Programit “Alumni – Ekselencat”, i cili synon të ruajë dhe të zhvillojë më tej kontaktet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe përfituesve nga Fondi i Ekselencës.

KREU IV

KRITERET PËR PËRFTITIMIN E FINANÇIMIT

I. Bursa të posaçme, për studentë që kryejnë studimet e ciklit të dytë jashtë vendit

1. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë, për përfitimin e mbështetjes financiare, janë përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”.

2. Studentët që aplikojnë për t’u mbështetur financiarisht, me bursë nga Fondi i Ekselencës, për vitin e dytë apo në vijim të studimeve, duhet të kenë arritur mesataren e notave mbi 8, për vitin pararendës të studimeve dhe të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike. Për studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë “Bachelor” jashtë vendit, konvertimi i mesatares në sistemin shqiptar të vlerësimit, kryhet nga Komisioni Përzgjedhës, bazuar në precedentët e viteve të mëparshëm dhe në informacionin mbi sistemin përkatës të vlerësimit të vendit ku janë kryer studimet e ciklit të parë “Bachelor”.

3. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) tarifës së studimit;

b) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik;

c) shpenzimeve të një udhëtimit në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

II. Bursa të posaçme, për studentë që kryejnë studimet e ciklit të tretë “Doktoratë jashtë vendit”

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që ndjekin jashtë vendit studimet e plota të doktoratës, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare, për përfitimin e mbështetjes financiare, janë përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”.

2. Studentët që aplikojnë për t’u mbështetur financiarisht, me bursë nga Fondi i Ekselencës, për vitin e dytë apo në vijim të studimeve, duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të vitit pararendës.

3. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) shpenzimeve të jetesës në masën jo më shumë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/muaj për kohëzgjatjen e vitit akademik;

b) shpenzimet e një udhëtimit në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve Evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

III. Bursa të posaçme, për nëpunësit civilë që kryejnë studimet “Master” të ciklit të dytë apo të tretë me kohëzgjatje 1-vjeçare jashtë vendit

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që i përkasin kategorisë nëpunës civilë që ndjekin jashtë vendit një program 1 (një) – vjeçar “Master” të ciklit të dytë apo të tretë janë përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”.

2. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) tarifës së studimeve;

b) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik;

c) shpenzimeve të një udhëtimit në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve Evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

KREU V

NDËRPRERJA E FINANCIMIT/KTHIMI I MASËS SË BURSËS SË AKORDUAR

1. Ndërprerja e financimit për bursat e parashikuara më sipër, bëhet në rastet e mëposhtme:

a) kur studenti i ciklit të dytë ndërpret studimet për më shumë se 3 (tre) muaj, gjatë vitit akademik përkatës, përjashtuar rastet e sëmundjeve, të vërtetuara nga autoritetet mjekësore apo në raste fatkeqësive familjare dhe forcës madhore;

b) kur studenti nuk jep të gjitha provimet apo e përfundon vitin akademik me notën mesatare më të ulët se nota 8 (vlerësimi ndërkombëtar, sistemi anglosakson B);

c) kur studenti nuk plotëson gjithë detyrimet akademike të parashikuara nga institucioni i arsimit të lartë për vitin përkatës, duke konsideruar kohëzgjatjen normale minimale të programit përkatës;

ç) kur studenti nuk aplikon në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Detyrimi për të kthyer masën e bursës së përfituar:

a) përjashtohet nga universiteti pritës;

b) ndërpret studimet për të cilat është mbështetur financiarisht;

c) kur pas përfundimit të studimeve nuk ka shlyer detyrimin e punësimit në Shqipëri, sipas kushteve të parashikuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar;

ç) nuk kanë përmbyllur apo përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 (një) viti akademik pas përfundimit të afatit zyrtar të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të vërtetuara, të rasteve të fatkeqësive familjare, forcës madhore apo kur parashikohet nga universiteti pritës.

3. Detyrimi dhe modaliteti i punësimit në Republikën e Shqipërisë pas përfundimit të studimeve të financuara nga Fondi i Ekselencës, përcaktohet në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”.

4. Studentët, që kanë përfituar bursë dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, në këtë udhëzim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur midis përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, t’i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar në formë burse nga Fondi i Ekselencës, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, do të ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 16, datë 1.8.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, masës së financimit dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Komisioni Përzgjedhës, Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

SHTOJCË 1 PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR TË GJITHA KATEGORITË

1. Të dhëna që plotësohen në formular:

a) të dhëna të aplikantit (emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datë e lindjes, vendlindja, shteti, qyteti, adresa e banimit, adresa elektronike, numri i tel etj.).

b) informacioni akademik (universiteti i studimeve pararendëse, kohëzgjatja e studimeve pararendëse, universiteti ku është pranuar, emërtimi i plotë programit të studimit, kohëzgjatja zyrtare, tarifa e studimit dhe shpenzimet e jetesës për vitin I të studimeve, renditja e universitetit sipas Times Higher Education, masa totale e financimit të kërkuar);

c) deklarata që nuk përfiton apo nuk ka përfituar në të kaluarën ndonjë bursë apo financim tjetër nga shteti shqiptar;

d) deklarata që autorizon ministrinë përgjegjëse për arsimin, për trajtimin dhe përpunimin e të dhënave personale të aplikantit, si dhe publikimin eventuale të të gjitha të dhënave që kanë lidhje me studimet e financuara nga Fondi i Ekselencës.

2. Dokumentacion që bashkëlidhet elektronikisht gjatë plotësimit të formularit:

a) letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas Times Higher Education (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

b) diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” (për të gjitha kategoritë) dhe e ciklit të dytë për kandidatët që do të ndjekin studimet e doktoratës (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

c) vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit;

d) CV-ja e kandidatit;

e) deklaratën për autorizimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në marrjen e informacionit zyrtar nga Universiteti në të cilin kandidati është pranuar, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

f) deklaratën noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi. (dërgohet edhe me postë);

g) në rast bashkëfinancimi ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose të huaja të paraqitet dokumentacioni që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose të huaja (përfshirë ato shtetërore);

h) projektidea e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht objekti kryesor i studimit dhe metodologjia (vetëm për studentët e Doktoratës);

i) miratimin e titullarit të institucionit të administratës shtetërore ku punon nëpunësi, sipas formatit të parashikuar në shtojcën 5 të këtij udhëzimi (vetëm për nëpunësit civilë).

SHTOJCË 2

PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR STUDENTËT E NDËRMJETËM

1. Të dhëna që plotësohen në formular:

a) të dhëna të aplikantit (emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datë e lindjes, vendlindja, shteti, qyteti, adresa e banimit, adresa elektronike, numri i tel etj.);

b) informacioni akademik (universiteti ku është financuar nga Fondi i Ekselencës vitin e mëparshëm, emërtimi i plotë programit të studimit, viti i studimit të përfunduar, tarifa e studimit dhe shpenzimet e jetesës për vitin e ardhshëm të studimeve).

2. Dokumentacion që bashkëlidhet elektronikisht gjatë plotësimit të formularit:

a) lista zyrtare e notave për vitin pararendës të studimeve të financuar nga Fondi i Ekselencës (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

b) vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve akademike për vitin pararendës;

c) vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë për periudhën e qëndrimit dhe frekuentimit të institucionit ku ndiqen studimet (vetëm për studentët e Doktoratës);

d) deklaratën për autorizimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin në marrjen e informacionit zyrtar nga universiteti në të cilin kandidati është pranuar, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

e) një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jofinanciare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit;

f) dokumentacion justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar për vitin e mëparshëm (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë).

SHTOJCË 3

AUTHORISATION LETTER

I, _____ hereby authorise the Ministry of Education, Sports and Youth of Albania to enquire/ retrieve any information regarding my studies at _____

I also authorise the release of any information to the above Institution for verification purposes.

Full name: _____

University: _____

Signature: _____

Date: _____

SHTOJCË 4

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruar _____ i/e datëlindjes _____,
(emër atësi mbiemër) (datë/muaj/vit)

aplikant/kërkues i mbështetjes financiare nga programi i Fondit të Ekselencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për kryerjen e studimeve jashtë vendit,

Deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se të gjitha të dhënat që kam plotësuar në formularin e aplikimit në programin e Fondit të Ekselencës me nr. reference: _____ janë të sakta dhe të vërteta.

Deklaruesi

(emër atësi mbiemër nënshkrimi) Datë ____/____/____

SHTOJCË 5

EMBLEMA E INSTITUCIONIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.

AUTORIZIM

Autorizoj Z/znj. _____, të aplikojë në programin e Fondit të Ekselencës, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për mbështetje financiare për kryerjen e studimeve master, në fushën e _____ në universitetin _____.

Titullari i institucionit

Firma

Vula